Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br 147/17
Datë/Datum 01.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Ak	Menaxherin e prokurimit: **Komuna e Vitisë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.147/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit _____		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Mbikqyrja e projekteve investive të Komunës së Vitis"**, me nr. prokurimi: **657/17/1392/221**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "Shkelqimi projekt & Al Engineering"**		
Datë	**01.06.2017.**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mbikqyrja e projekteve investive të Komunës së Vitis"**, me nr. prokurimi: **657/17/1392/221,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Viti,** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE **"Shkelqimi projekt & AL Engineering"**, me seli në Viti dhe Prishtinë, me nr.prot.**147/17**, i datës **19.05.2017**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		24.05.2017		25.05.2017		01.06.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 19.05.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 147/17, e parashtruar nga operatori ekonomik ankues "Shkelqimi Projekt & Al Engineering"-Viti dhe Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mbikqyrja e projekteve investive të Komunës së Vitis"**, me nr. prokurimi: **657/17/1392/221**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Viti.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: "Shkelqimi projekt & Al Engineering"-Viti dhe Prishtinë.

Pikat e Ankesës:
AK ka shkelur Nenin 10 dhe 11 të LPP-së.

AK ka shkelur Nenin 27 të LPP-së.

AK ka shkelur Nenin 41 dhe 54 të LPP-së.

AK ka shkelur Nenin 59 të LPP-së.

AK ka shkelur Nenin 60 të LPP-së.

AK ka shkelur Nenin 72 të LPP-së.

AK ka shkelur nenin 108/A, i LPP-së.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Para se të filloj të përshkruaj faktet mbi shkeljet e AK-së dua të ju njoftoj se ne kemi parashtruar fillimisht kërkesën për Rishqyrtimin e Vendimit të AK tek Komuna e Vitisë. Keta të fundit e kanë shqyrtuar kërkesën tonë dhe njëjtë sikur me rastin e vlerësimit mendojmë se kanë vepruar në shpërputhje me LPP ku në këtë rastë kanë kanë shkelur nenin 108/A të LPP-së, pasi që nuk i kanë marrë për bazë asnjë nga kërkesat dhe faktet e paraqitura në këtë kërkesë për shkeljet dhe devijimet që kanë qenë gjatë procesit të vlerësimit si dhe gjatë procesit të qasjes në dokumentacionin e tenderit.

1. Autoriteti Kontraktues - Komuna e Vitisë përkatësisht Zyra e Prokurimit ka bërë shkelje të nenit 10 të LPP-së pasi që edhe përkundër kërkesës tonë për qasje në dokumentacionin e tenderit, nuk na ka lejuar te kemi qasje në dokumentacionin e tenderit. Pas dërgimit të kërkesës për qasje ne dokumentet e tenderit ne formën elektronike dhe fizike dhe pas shume insistimeve na eshte thene qe mundeni te shihni dokumentet e tenderit. Mirpo kur kam filluar te interesohem per oferten e OE qe ata e kishin perzgjedhur si fitues dhe duke kërkuar të shohë se a është i përgjegjshem, atehere Zyrtari kryesor i prokurimit nuk me

ka lejuar duke me thene qe te gjitha dokumentet i ka sekret afarist. Pas kerkeses tonë per te pare dokumentin (formularin stadard 'kërkesë për konfidencialitet") për përcaktimin e sekreteve afariste te OE, të cilën Zyrtari i Prokurimit nuk e gjeti ne ofertën e OE, atehere filloi te me akuzoj per gjera se gjoja ne po bejme qellimisht kete veprim dhe se kemi qellime tjera duke na e ndaluar qasjen e metutjeshme. Me kete Veprim na ka shkaktuar probleme pasi qe kerkesen per rishqyrtim e po ashtu edhe tash ankesën për OSHP e kemi bërë duke mos pasur informata te mjaftushme per rregullsinë e procesit te prokurimit e veçmas pjeses se vlerësimit. Nisur nga kjo hartimin e kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të AK dhe Ankesën në OSHP e kemi përgatitur pa pasur informata te sakta rreth shkeljeve te mundshme. Përpos kësaj kjo i jep mundesin AK qe të bëjë permiresime dhe ndryshime ne procesin e prokurimit sepse ne nuk kemi shumë informata rreth dokumentacionit te ketij procesi dhe ofertave të OE. Po ashtu AK ka shkelur edhe nenin 11 te LPP lidhur me klasifikimin e informatave si sekret afarist pa kërkesën e OE.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Vitisë ka bërë shkelje të nenit 27 të LPP-së. pasi që gjatë hartimit të dosjes së tenderit ka parashtruar kërkesa jo të qarta për Opertaorët Ekonomik. Kjo ka të bëjë me kërkesën: Inxhinierët e stafit të deklarohen me shkrim se nuk janë të angazhuar në projekte të tjera, ku nuk eshte e saktësuar se për cilat projekte bëhet fjalë(te Komunës së Vitisë apo në çdo projekt tjeter). Kjo kërkesë nuk është në përputhje me kërkesat dhe rregullat e Ligjit të Prokurimit Publik.

AK-ja ka shkelur nenin 41 dhe 54 të LPP-se dhe nenin 22 te Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit (RUOP) lidhur me njoftimet qe duhet bere ne proceset e prokurimit. Ka shkelur nenin 41 ku edhe pas marrjes së vendimit per perzgjedhjen e OE fitues dhe njoftimit të OE të eliminuar, njoftimin per dhenje nuk e ka bere deri 7 ditë mbrapa njoftimeve për eliminim duke shkelur edhe nenin 22 te RUOP-se. Ka shkelur nenin 54 lidhur me njoftimin e OE te eliminuar duke mos i njoftuar ata se kush eshte shpallur fitues ne procesin e prokurimit. Kete veprim mendoj se AK e ka bere me qellim që OE te gabojne dhe të ju ik afati për ankese prej 5 diteve nga dita e njoftimit me shkrim. Sipas rregullores se publikuar ne vebfaqen e KRPP-se nese njoftimi per dhenje dhe njoftimi i OE te pasusksesshem nuk kane datat e njejta atëhere bazë për llogaritjen e këtij afati merret data e njoftimit me shkrim te OE. Kjo edhe na ka shtyr qe te kerkojme qasje te menjehershme ne dosjen e tenderit sepse ndryshe do të na ikte afati kohore. Andaj veprimin tim si këmngulje për qasje në dokumente zyrtari i prokurimit e ka vlerësuar si lloj kërcënimi për çka edhe ka lajmëruar policinë. Kur unë shkova në polici për ta paraqitur rastin për sjelljen e dhunshme të zyrtarit të prokurimit dhe largimin tim nga Zyra duke ma pamundësuar qasjen në kërkesat reale që mi ofron ligji, kuptova se ai kishte paraqitur rastin kundër meje. Ky veprim i Zyrës së Prokurimit eshte i qëllimshëm dhe është në kundërshtim me kërkesat dhe rregullat e LPP-së mbi publikimet e njoftimeve.

AK-Zyra e Prokurimit ka shkelur nenin 59 dhe 60 të LPP-së që ka të bëjë me vlersimin e ofertave dhe kriteret e vlerësimit. AK nuk ka bërë vlerësimin në përputhje me këtë nen pasi që nuk i ka vlerësuar ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Neve jemi eliminuar për për disa kërkesa që i kemi plotësuar dhe i kemi pas në dosjen e tenderit (shihi deshmit e bashkangjitura). Jemi anuluar për mungesën e një kontrate të një puntori por në ofertën tonë është paraqitur një listë e punëtorve që janë të lajmëruar në ATK dhe figuron emri i tij. Ky dokument ndodhet në dosje dhe vërteton këtë fakt. Në këtë rastë AK nuk ka rrespektuar paragrafin 2 të nenit 59 të LPP si dhe nuk e ka rrespektuar as nenin 72 të LPP për sqarim të ofertës pasi që më shumë ofron vërtetësi lista e punëtorve të lajmëruar në ATK ku shihen qartë pagesat mujore se sa një kontratë e cila mundet me qenë shumë lehtë fiktive. Vërejtjet tjera janë se na mungojnë dy referenca, na mungon lista e Stafit, na mungon vendimi

për caktimin e menagjerit të projektit dhe deklarat e inxhinierve që nuk janë te prfshirë në projekte tjera. Këto janë të paqëndrueshme pasi që në ofertën tonë janë tre referenca ashtu siq edhe janë kërkuar(shihi dëshmin e bashkangjitura), lista e stafit nuk eshte kërkuar fare në dosjen e tenderit(shihe dosjen e tenderit), menaxheri i projektit është caktuar me vendim të konzorciumit, shihe dokumentin që ekziston në dosje për këtë emrim(shihe dëshmin e bashkangjitur). Deklaraten për mos angazhim të inxhinierve nuk e kemi paraqit sepse inxhinerët tane nuk janë të angazhuar në asnjë projekt të Komunës së Vitisë por problemi ka qenë tek kërkesa e parashtruar gabim nga Zyra e Prokurimit e cila nuk ka qenë e specifikuar se për cilat projekte bëhet fjalë(shihe FTD lidhur me kërkesën). Me që kërkesa ska qenë e specifikuar nuk kemi mundur edhe të deklarohemi sepse është e pamundur që një kompani të ketë vetëm një kontratë për një vit(të kufizohet vetëm me kontratën e Komunës së Vitisë). Kërkesa ka qenë për mospërfshirje në ndonjë projekt tjeter por nuk e ka saktësuar se për cilat projekte bëhet fjalë pra po mendoj që u dashtë me saktësu që kjo vlenë vetëm për projekte të Komunës së Vitisë apo edhe më gjërë. Të gjitha kompanit konkurrojnë nëpër tender të ndryshëm nëpër AK tjera dhe munden edhe te fitojnë ndonjë kontratë. Kjo nuk paraqet kurfar problemi nëse kompania jonë fiton tenderin për mbikqyrje të projekteve të Komunës së Vitisë pasi që kryesorja është që në projekte të kësaj komune inxhinierët nuk janë të përfshirë. Përpos tjerash OE i përzgjedhur si fitues ka deklarata të inxhinierve për mos angazhim në projekte tjera por realisht ata janë të përfshirë në projekte tjera dhe i bie që deklaratat janë jo reale. Bazuar në kërkesësn e paspecifikuar mirë të AK i bie që ky OE ka ofruar informata jo të vërteta në ofertë që nuk përkojnë me deklaratën nën betim të nënshkruar nga OE. Kjo i bie që edhe fituesi sipas kërkesës së AK është i papërgjegjshëm. Me përzgjedhjen e këtij OE si fitues dhe anulimin tonë. AK ka shkelur edhe nenin 60 të LPP-së duke mos na përzgjedhur neve si fitues edhe pse kemi pasur çmimin më të ulët në krahasim ne tenderuesin e përzgjedhur.

5 AK nuk ka vepruar sipas kërkesës së nenin 72 të LPP-së në rastin e vlerësimit të ofertës tonë pasi që nuk ka kërkuar sqarime shtesë për disa paqartësi të vogla të ofertës tonë. Kjo ka të bëjë me sqarimin e listës së punëtorëve të lajmëruar në Administratën Tatimore e Kosovës. Në këtë rastë neni 72 i LPP shumë qartë e rregullon këtë qështje mirpo AK nuk e ka rrespektuar. Ky punëtor ka kontratë me kompanin tonë dhe këtë e dëshmojmë me dokumentacionin e bashkangjitur.

6. AK-ja ka shkelur nenin 108/A të LPP-së pasi që gjate shqyrtimit të kërkesës tonë për Rishqyrtimin e Vendimit të AK nuk ka marë për bazë asnjë nga faktet e paraqitura nga ne. Përgjigjja e tyre eshte e mangët, e pabazuar në fakte, dhe rishqyrtimi nuk është bërë në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit. AK-ja ka përdorur kritere shtesë gjatë shqyrtimit të kërkesës tonë dhe veprimet e tilla bien ndesh me LPP-në.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....08.04.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....Procedur e hapur
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): ..... kontrat korniz me një operator/ shërbim/ vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 19.04.2017
Data e hapjes së ofertave (N.58):.....19.04.2017-ora 14;00h
Njoftimi për dhënien e kontrates.....08.05.2017
Kriter për dhënien e kontratës.....Çmimi më i lartë

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lote	Çmimi	Vërtetje
1	NPN "Eng-Idea"	Suharekë	-	580.00€	JO
2	Konz. "Kapital x" sh.p.k& "Enggroup" sh.p.k	Prishtinë	-	0.69€	Oferta në letër
3	Konz. "Shkëlqimi-Projekt"&AL Engineering" sh.p.k	Prishtinë	-	0.38€	Oferta në letër
4	Konz. "PMN" sh.p.k & "NPN Univers-MI"	Prishtinë	-	0.42€	Oferta në letër

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë kater (4) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes NUK është rexhistruar vërejtje në lidhje me hapjen e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

a) Deklarata nën betim se operatori përmbush kërkesen mbi përshtatëshmerin të ligjit të prokurimit nr. 04/L-042, neni 65 - Obligative.

b) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik , se opersatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tre mujorin e fundit para dorëzimit tëtenderi.....Obligative.(Per fituesin).

c) Vërtetimin e gjykates ekonomike.. Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që përmbush "kërkesat e përshtatshmërisë"(Të mos jetë më i vjetër se gjashtë muaj nga dorëzimi i tenderit)..... Obligative.(Per fituesin).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) Deklarata nën betim, në dosje e vulosur dhe e nënshkruar.

b) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore – origjinal.

c) Vërtetimin e gjykatës ekonomike -origjinal ose kopje e noterizuar.

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH-s.
Kërkesa 3. Regjistrimi i Numrit fiskal.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmi 1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës.

Dëshmi 2. Kopja e TVSH-së

Dëshmi 3. Kopja e Numrit fikal.

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

N/A

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional:
1.Kontrata te projekteve per te sherbime te ngashme, min, tri kontrata ne tri vitet e fundit.
2.a.) OE duhet te kete minimumin e STAFI PROFESIONAL, te paraqitur: 1. Një inxhinier i diplomuar i arkitekturës.
2. Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë-Hidroteknik.
3. Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë-konstruktit.
4. Një inxhinier i diplomuar i drejtimit Elektroteknikës.
5. Një inxhinier i diplomuar i makinerisë.
6. Një inxh. i gjeodezisë. Menaxheri i projektit të jetë inxh.i diplomuar i ndërtimtarisë- dr.konstruktiv ose arkitekt me përvojë minimum 10 vite, nga diplomimi të dëshmuar në CV b.) Një deklaratë (listë)e mjeteve apo pajisjeve adekuate për realizimin e këtyre shërbimeve që konkuroni.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Lista e projekteve te ngjajshme per tri vitet e shkuara ,(2014-2016) min. tri kontrata te realizuar bashkangjitur me referencat

2.Pika a.1-6. Diplomat përkatëse-copje të noterizuara, CV dhe kontratat e punes valide si deshmi per marrdhenjen e punes, ose parakontrata per projektin. Inxh. e stafit te deklarojne me shkrim se nuk jane te angazhuar ne projekte te tjera. Menaxheri i projektit te caktohet me vendim nga ana e OE.

Pika b. Një liste e vulosur nga firma si dëshmi e mjeteve të punës dhe pajisjeve, minimum DY vetura ne emrin e kompanisë,ose me qera dëshmi librezën.

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).
Xhelal MUSA: Kryesues,
Mifail AZIZI: Anëtar,
Destan AVDYLI; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 04.05.2017.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka REKOMANDUAR për dhënien e kontratës, konzerciumin e OE-ve "PMN sh.p.k&NPN Univers-MI", me seli në Prishtinë.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur të hapur, kontrat publike korniz me një operator, me vlerë të mesme, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi çmimi më i ulët". I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës, të datës 08.05.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues "Shkëlqimi Projekt&AL Engineering", me seli në Viti-Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP me datë 19.05.2017, me pretendimet ankimore se janë shkelur neni:

Nenin 10 dhe 11 të LPP-së.

Nenin 27 të LPP-së.

Nenin 41 dhe 54 të LPP-së.

Nenin 59 të LPP-së.

Nenin 60 të LPP-së.

Nenin 72 të LPP-së.

Nenin 108/A, i LPP-së.

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Pretendimi ankimor 1,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 10 dhe 11 të LPP-së, qasja në dokumentet zyrtare,

Eksperti shqyrtues bazuar në shkresat e lendes vlerëson se OE ankues ka pasur qasje në dokumentet e ofertes së tij por gjatë qasjes në dokumentacion kanë filluar kërcënimet verbale mes paleve dhe i njëjti rast ka përfunduar në Policin e Kosovës.
Në lidhje më këtë pretendim ankimor, Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pjesërisht ky pretendim ankimor për faktin se Autoriteti kontraktues gjatë qasjes në dokumentacion zyrtar është dashur të lejohet qasje e pa kufizuar edhe në ofertën e OE të rekomanduar për kontrat, pasi që OE i rekomanduar për kontrat NUK ka specifikuar kërkes për sekret afarist në ofertën e tij ndonjë dokumentacion në ofertën e tij.

Pretendimi ankimor 2,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 27 të dosjes së tenderit, në lidhje me kërkesat e dosjes së tenderit.
Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron ky pretendim ankimor për faktin se OE ankues gjatë fazes tenderuese nuk ka parashtruar ankes apo kërkes për s'qarime shtesë në lidhje me kriteret e FDT-së.
Eksperti shqyrtues, sqaron për OE ankues se si palë e interesit konform nenit 108/A te LPP-se, paragrafit 3.1, ku thuhet: **në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet**

e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave; Eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim sipas paragrafit 3.1 te nenit 108/A (kundër njoftimit për kontratë), lidhur me s'qarimin e kritereve sa i përket deklarates nga inxhinieret që nuk janë të angazhuar në projekte tjera.

Pra, OE ankues sipas dispozitave te lartpërmendura, është dashur qe te parashtroj ankesë ne fazën e njoftimit për kontratë, ndërsa ne këtë faze (Njoftim për dhënie te kontratës), AK-ja sipas dispozitave te nenit 59.4 te LPP-se, duhet te vlerësoj një ofertues si te përgjegjshëm vetëm nëse oferta është ne përputhje te plot me kërkesat e dosjes se tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Pretendimi ankimor 3,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 41 të LPP-së, duke aluduar se AK-ja ka bërë shkelje të afatit të publikimit të Njoftimit për dhënien e kontratës,

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron ky pretendim ankimor, për faktin se dispozita 41 e LPP-së, nuk ka të bëjë fare me atë se qka pretendon OE ankues, kjo dispozit paraqet: citojm nenin 41 të LPP-së "*Nëse autoriteti kontraktues ka dhënë një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, konkurruese me negociata, e negociuara pa publikim, ose procedurat e kuotimit të çmimeve, autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas dhënies së kontratës së tillë, do të përgatisë njoftimin mbi dhënien e kontratës në gjuhët e cekura në nenin 13 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të sigurojë, që versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi për dhënien e kontratës, janë në përputhshmëri me këtë ligj dhe se përmbajnë informata materialisht identike. Autoriteti kontraktues, së bashku me Njoftimin për dhënie të kontratës, duhet të dorëzoj në KRPP një kopje të deklaratës së Nevojave dhe Disponueshmërisë së mjeteve për kontratën e shpërblyer*".

Pretendimi ankimor 4,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 54 të LPP-së, duke pretenduar se AK-ja nuk ka bërë njoftimin e OE ankue me letër standarde për eliminim.

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor për faktin se në shkresat e lendes nuk kemi hasur në dokument apo e-mail të printuar që dëshmon se OE ankues është njoftuar me letër standarde.

Eksperti shqyrtues konstaton se AK-ja në shkresat e lendes ka paraqitur nje shkresa të shenuar me email adresat dhe njoftimin për eliminim të OE-ve, por kjo shkresa nuk printuar nga forma origjinale prej emailit, por është përpiluar nga vet ana e AK-së, e cila për mendimin tim është e pavlefshme.

Pretendimi ankimor 5,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 59 dhe 60 të LPP-së, duke pretenduar se AK-ja nuk ka bërë vlerësimin e ofertës në harmoni me nenin 59 dhe 60 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor për faktin se OE ankues ka ofruar ofertë të papërgjegjshme sepse OE ankues ka disa mangësi në ofertën e tij si në vijim:

- Nuk ka plotësuar pikën 9.1 dhe 9.2 të FDT-së në lidhje me referencat e ngjashme.
- Nuk ka plotësuar pikën 9.1.2a të FDT-së, në lidhje me kontraten e inxhi. Shkelzen Rexha.
- Nuk ka plotësuar pikën 9.1.2a të FDT-së, në lidhje me vendimin e menaxherit të projektit, nuk ka ofruar vendim për caktimin e menaxherit të projektit, poashtu në të njejtën pike të FDT-së është kërkuar deklarata me shkrim e inxhiniereve se nuk janë të angazhuar ndonjë projekt tjetër, nuk është plotësuar nga ana e OE ankues fare
- Poashtu OE ankues ka ofruar marveshjen për marrje me qira të mjeteve të punës, e njëjta është e pa-vulosur nga pala kontraktuar.

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 60 të LPP-së kriteri për dhënien e kontratës, vlerëson se NUK qëndron për faktin se kriter për dhënien e kontratës në FDT dhe njoftimin për

kontrat është: Tenderit përgjegjshëm çmimi më i ulët, në rastin konkret OE ankues ka ofruar ofertë të papërgjegjshëm, dhe nuk mjafton vetëm çmimi të jetë me i ulet nëse oferta nuk është e përgjegjshme.

Pretendimi ankimor 6,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 72 të LPP-së, duke pretenduar se AK-ja nuk ka kërkuar s'qarime shtesë në lidhje me ofertën e OE ankues.
Eksperti shqyrtues vlerëson duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së, vlerëson se është e drejt ekskluzive e AK-së për të kërkuar plotësim të dokumentacionit në lidhje me këtë nen.

Pretendimi ankimor 7,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 108/A të LPP-së, lidhur me kërkesën për ri-shqyrtim të vendimit të AK-së dhe pezullimin e aktivitetit të prokurimit, pas parashtrimit të ankesës nga ana e OE ankues. **Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK** qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë, për faktin se Autoriteti kontraktues ka bërë shqyrtimin e kërkesës për ri-shqyrtim të parashtruar nga ana e OE ankues dhe për të njejtën (ankes) ka nxjerrur vendim me datë 12.05.2017, me nr, prot.02-230/04-18111, për refuzim si të pa-bazuar të kërkesës për ri-shqyrtim të parashtruar nga ana e OE ankues.

Pretendimi ankimor 8,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket ofertës të OE të rekomanduar për kontrat, se i njëjti ka ofruar inxhinier të angazhuar në projekte tjera,
Eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim është i pa-bazuar, për faktin se OE ankues nuk ka ofruar asnjë dëshmi që vërteton në lidhje me pretendimin ankimor, dhe në bazë të shkresave të lendes nuk askund mundem të vertëtojm të njëjtin pretendim ankimor se inxhinieret e OE të rekomanduar për kontrat janë të angazhuar ndonje projekt tjetër.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të aprovoj pjesërishtë të BAZUARA (në lidhje me nenin 10 dhe 54 të LPP-së) ankesën OE ankues konz. "Shkëlqimi Projekt&Al Engineering", me seli në Vit-Pr, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të APROVOJ vendimin "Njoftimi për dhënien e kontratës", me nr. prokurimi: 657/17/1392/221", dhe ky aktivitet i prokurimit të vazhdoj më tutje, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK VITI.